



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.73/2016

Prishtinë, më 7.10.2016, në orën 23:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Rustem Berisha dhe Enver Hoti, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Sasha Milosavljeviq, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Projektligjit Nr. L-120 për Trepçën;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Projektligjit Nr. L-120 për Trepçën;

Kryetari, njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisionet e përhershme i kanë shqyrtuar amendamentet e Komisionit, ku vetëm komisioni për legjislacion ka paraqitur një rekomandim në amendamentin 10, ku thuhet se “formulimi aktual lë hapësirë të interpretohet që statuti pas miratimit nga Kuvendi i njëjti duhet t’i nënshtrohet edhe njëherë miratimit nga aksionarët”. Kryetari sqaroi se formulimi siç e ka bërë Komisioni Funkcional, është në rregull sepse ka të bëjë me shoqëri aksionare, ku aksionarët, pas pëlqimit të Kuvendit e miratojnë një çështje.

Besim Beqaj, propozoi që në këtë amendament, pra në amendamentin 10, pas fjalës “aksionarët”, të hiqet presja “,”, dhe në këtë mënyrë formulimi do të ketë kuptimin e duhur.

Komisioni e përkrahu propozimin e z.Beqaj.

Sala Berisha-Shala, lidhur me amendamentin 13, propozoi që fjala “gjeoshkencave” të renditet para fjalës “ekonomisë” apo si fjali e parë e jo siç është tani pas fjalës “drejtësisë” sepse kështu e ka prezantuar në mbledhje dhe nuk i ka pasqyruar amendamenti siç e ka prezantuar.

Kryetari, theksoi se nuk ka rëndësi renditja dhe le të mbetet ashtu si është në amendament.

Sala Berisha-Shala, përsëri kërkoi që fjala “gjeoshkencave” të renditet para fjalës “ekonomisë”, pasi që drejtimi i gjeoshkencave është më i rëndësishmi në sektorin minerar.

Fatmir Rexhepi propozoi që fjala “gjeoshkencave” të renditet pas fjalës “ekonomisë”, pasi që fusha e ekonomisë duhet të jetë e para sepse kemi të bëjmë me menaxhim.

Komisioni më shumicë votash e përkrahu propozimin e z.Rexhepi.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën;

2. Raporti me Rekomandime t’i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

3. Të ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 23:45.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa